



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:074294

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05905854

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ–Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.T. nga Ferizaji, me numër personalZ.N. ,nga Sh.me numër personal,A.V. ,nga Ferizaji ,me numër personal,H.T. , ,nga Ferizaji ,Rr"’G.S.”,me numër personal.....,M.G. ,nga fshati V.Komuna e Shtërpcës ,me numër personaltë cilët në bazë të autorizimit i përfaqëson av.Rafiz Shehu ,nga Ferizaji, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë–Drejtoria Rajonale në Ferizaj, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti kompensim i pagës së trembëdhjetë, me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve N.T. nga Ferizaji, me numër personalZ.N. ,nga Sh.me numër personal,A.V. ,nga Ferizaji ,me numër personal,H.T. , ,nga Ferizaji ,Rr"’G.S.”,me numër personal.....,M.G. ,nga fshati V.Komuna e Shtërpcës dhe detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë–Drejtoria Rajonale në Ferizaj që paditësve, N.T. nga Ferizaji, me numër personalZ.N. ,nga Sh.me numër personal,A.V. ,nga Ferizaji ,me numër personal,H.T. , ,nga Ferizaji ,Rr"’G.S.”,me numër personal.....,M.G. ,nga fshati V.Komuna e Shtërpcës, t’ua paguaj shumat si në vijim:

Paditëse N.T. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018,2019,2020,2021,2022, shumën prej 3172.26 euro, me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data 01.01.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së aktgjykimit.

Paditëses Z.N. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2019,2020,2021,2022, shumën prej 1847.87 euro, me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data 01.01.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së aktgjykimit.

Paditëses A.V. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018,2019,2020,2021,2022 , shumën prej 3005.30 euro, me kamatë prej 8 % në vit duke

filluar nga data 01.01.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së aktgjykimit.

Paditëses H.T. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 shumë prej 3237.58 euro me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga dita 01.01.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së aktgjykimit.

Paditëses M.Gj. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2019, 2020, 2021, 2022 shumë prej 2199.33 euro me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga dita 01.01.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së aktgjykimit.

II. Detyrohen e paditura Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë–Drejtoria Rajonale në Ferizaj që N.T. nga Ferizaji, me numër personalZ.N. ,nga Sh.me numër personal,A.V. ,nga Ferizaji ,me numër personal,H.T. , ,nga Ferizaji ,Rr’G.S.’,me numër personal.....,M.G. ,nga fshati V.Komuna e Shtërpcës ,në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore tua paguaj shumat siq vijon :per hartimin e padis 624 euro,për taksen për padi 101 euro,për një seancë gjyqësore 811 euro të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësit N.T. nga Ferizaji, me numër personalZ.N. ,nga Sh.me numër personal,A.V. ,nga Ferizaji ,me numër personal,H.T. , ,nga Ferizaji ,Rr’G.S.’,me numër personal.....,M.G. ,nga fshati V.Komuna e Shtërpcës kanë parashtruar padi në këtë gjykatë ,kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë–Drejtoria Rajonale në Ferizaj ,me bazë juridike kompensimi i pagës së 13 për vitete 2018,2019,2020,2021,2022.

Nga thënjet e paditësve në padi ,me parashtrës dhe gjatë shqyrtimit kryesorë gjyqësorë rezulton se të njejtit kërkesëpadin e bazojnë në faktin se janë të punësuar te e paditura në Shërbimin Policorë të Kosovës,por e paditura paditësve nuk ua ka paguar pagën e 13 edhe pse një e drejtë e tillë ju takon në bazë të legjislacionit në fuqi edhe atë:Ligjit për Policinë e Kosovës neni 47,në lidhje me nenin 29 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovë,i cili ka hyrë në fuqi me date 14.11.2018,sa i përket pagave të 13 për vitet 2018.2019.2020,2021 dhe në bazë të nenit 30 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovë,i cili ka hyrë në fuqi me date 29.09.2021 sa i përket pagave të 13 për vitin 2022.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve av.Rafiz Shehu ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia me përmbajtje si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pika I dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën II.

E paditura Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë-Drejtoria Rajonale në Ferizaj,në përgjegje në padi përmes avokaturës shtetërore e ka kundërshtuar padin dhe kërkesëpadin e paditësve duke u bazuar në theksimet si në vijim:Paditësit nuk i kanë shterrur procedurat e brendshme të apelimit te organi i tyre i punësimit siq parashihet me nenet 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.Kërkesa e paditësve nuk është realizuar për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe si rrjedhojë Ministria e Financave nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës për pagesa të tilla.Dhe dispozita me të cilën parashifet pagesa e pagës së 13 nuk është e karakterit detyrues ,por zbatimi i sajë varet nga mundësit buxhetore për të bërë një pagesë të tillë.Padia është paraqitur pas afatit .

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Fakti se paditësit ishin punëtorë të të paditurës në Shërbimin Policorë të Kosovës,për periudhën për të cilën kërkojnë kompensim 2018,2019,2020,2021,2022 nuk ishte kontestuese ndërmjet palëve ,por që vërtetohet edhe nga vërtetimet e lëshuara nga e paditura si në vijim :Vertetimi nr..... i datës 06.04.2021 ne emër te N.T.; Vertetimi me numërne emër të Z.N.; Vertetimi numër ... ne emër te A.V. Vertetimi numër ne emër te H.T., Vertetimi numër ne emër te M.Gj.

Nga kartela e nënpunësit në emër të N.T. ,e lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se e njejta për periudhën për të cilën kërkon kompensim –muaji dhjetor ka marrur pagë :viti 2018,514.45 euro ,2019,699.73 euro,2020,765.05 euro ,2021,562.80 euro ,2022,735.63 euro.

Nga kartela e nënpunësit në emër të Z.N. ,e lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se e njejta për periudhën për të cilën kërkon kompensim –muaji dhjetor ka marrur pagë :viti 2019,451.83 euro,2020,707.78 euro ,2021,233.42 euro ,2022,454.94 euro.

Nga kartela e nënpunësit në emër të A.V. ,e lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se e njejta për periudhën për të cilën kërkon kompensim –muaji dhjetor ka marrur pagë :viti 2018,648.44 euro ,2019,758.73 euro,2020,815.93 euro ,2021,575.78 euro ,2022,332.82 euro

Nga kartela e nënpunësit në emër të H.T. ,e lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se e njejta për periudhën për të cilën kërkon kompensim –muaji dhjetor ka marrur pagë :viti 2018,509.13 euro ,2019,655.65 euro,2020,765.05 euro ,2021,567.81 euro ,2022,740.27 euro

Nga kartela e nënpunësit në emër të M.Gj.e lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se e njejta për periudhën për të cilën kërkon kompensim –muaji dhjetor ka marrur pagë :viti ,2019,451.83 euro,2020,704.06 euro ,2021,599.50 euro ,2022,598.42 euro

Nga formularët e vlerësimit për vitet 2018,2019,2020,2021 ,2022 ,për paditësit të lëshuar nga e paditura ,gjykata ka vërtetuar se të njejt për vitet që kërkojnë kompenzim kanë marrë vlerësim të knaqshëm dhe nuk kanë qenë subjekt i ndonjë mase disiplinore,kurse e paditura me asnjë provë nuk ka vërtetuar se paditësit kanë qenë subjekt i ndonjë mase disiplinore ose kanë marrë vlerësim jo të knaqshën ,sepse kemi të bëjmë me prova që i posedon organi punësimit.

Gjykata pasi vlerësoj provat e administruara ka aprovuar si të bazuar kërkesë kërkesëpadin e paditësve :sepse gjatë procedurës u vërtetuar se paditësit për periudhën për të cilën kërkojnë kompensim ishin punëtorë të të paditurës në Shërbimin Policorë të Kosovës dhe për vitet për të cilat kërkojnë kompensim kishin vlerësim të knaqshën dhe nuk u ishte shqiptuar ndonjë mas disiplinore andaj në bazë të Ligjit për Policinë e Kosovës neni 47,në lidhje me nenin 29 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës,i cili ka hyrë në fuqi me date 14.11.2018,sa i përket pagave të 13 për vitet 2018.2019.2020,2021 dhe në bazë të nenit 30 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës,i cili ka hyrë në fuqi me date 29.09.2021,sa i përket pages se 13 për vitin 2022 paditësit kanë të drejtë në realizimin e pages së 13 ,të cilën pagë e paditura nuk ua ka paguar paditësve,e fakti i fundit ishte jo kontestues në mes palëve.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e të paditurës kur thekson se ka munges të mjeteve buxhetore per pagesen e pages se 13 por kjo gjykate keto thenje i quan te pa bazuara ,sepse ne baze te nenin 29 të Udhëzimit Administrativ 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës,i cili ka hyrë në fuqi me date 14.11.2018 pagesa e pagese se 13 ka qene e detyrueshme ,kurse sa i perket Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës,i cili ka hyrë në fuqi me date 29.09.2021 eshte kushtezuar me pasjen e mjeteve buxhetore ,por barra e provave për të vërtetuar mungesen e mjeteve financiare bie në punëdhënësin i cili faktin e mungeses se fondeve nuk e ka arsyetuar me asnjë prove.

Sa i përket theksimit të të paditurës se Paditësit nuk i kanë shterrur procedurat e brendshme të apelimit te organi i tyre i punësimit siq parashihet me nenet 78 dhe 79 të Ligjit të Punës këto nuk mund të kenë ndikim në bazueshmërin e kërkesëpadisë ,sepse kemi të bëjmë me detyrime që kanë qenë të njohur për organin e punësimit dhe i njeiti ka qenë dashtë ti përmbush pa parashtruar ndonjë kërkesë të veqant nga punëtori.

Përveq kësaj Nuk qëndron pretendimi i të paditurës në raport me zbatimin e procedurës nga neni 78 dhe 79 i Ligjit të Punës, pasi kërkesa e paditësit nuk hyn në kategorinë e çështjeve për tu ngritur konform nenit 78 fillimisht te e paditura e më pastaj konform nenit 79 në gjykatë, për arsye se nga ana e punëdhënësit nuk ka ndonjë vendim paraprak të cilin do t'a godiste paditësi, por ka detyrim të përmbushjes nga ana e të paditurës.

Paditësit i plotësojnë kushtet për të përfituar një kompensim të tillë, pasi që janë në marrëdhënie pune te e paditura, nuk kanë pasur ë shqiptuar ndonjë masë disiplinore për vitet kontestueses, 2018, 2019 ,2020,2021,2022, ndërsa kanë pasur vlerësim të mirë për këto vite.

Pretendimi për mungesë buxheti apo mos harmonizimi i Udhëzimit Administrativ me Ligjin për buxhetin është aspekt i brendshëm i të paditurës me organet e veta, pastaj përderisa Udhëzimi ka qenë në fuqi, e paditura nuk mund t'i shmanget detyrimit për përmbushje. Fakti se nuk është bërë përmbushja në procedurë të brendshme administrative nuk nënkupton mungesë të bazës juridike për t'u detyruar nga gjykata për përmbushje.

Përveq kësaj e paditura me asnjë provë nuk ka vërtetuar se i ka përmbushur këto detyrime .kurse nga deklarimi i të paditurës përmes parashtrësës rezulton se këto detyrime nuk janë përmbushur për asnjë punonjës të policisë.

Sa i përket faktit se qka konsiderohet pagë është dhënë kuptimi nga Ligji Punës i Kosovës në nenin 3 paragrafi 1 pika 1.13 me të cilën dispozitë është paraparë se pagë konsiderohet shpërblimi ose fitimi i çfarëdo niveli të llogaritur e shprehur në para për të punësuarin.Kjo nënkupton se qdo pages që i bëhet të punësuarit në lidhje me punën konsiderohet pagë.Kurse udhezimet administrative të sipër përmendura parashohin pagesën e një page e cila paguhet në fund të vitit.

Vendimi per pagesen e shpenzimeve procedural është bazuar në nenin 451.2 të LPK-së,i cili vendim është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së.

Nga se u tha me lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Gjyqtari,
Burim Emërllahu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.